



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 11, datë 14.04.2017

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “RIKONSTRUKSION I KATIT TË TRETË, TË KATËRT DHE KATIT PËRDHE (PËRFSHIRË NDËRHYRJEN NË FASADËN JUGORE) TË GODINËS EKZISTUESE A1 TË MJEKËSISË SË PËRGJITHSHME, BRENDA TERRITORIT TË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE TË TIRANËS”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstrukcion i katit të tretë, të katërt dhe katit përdhe (përfshirë ndërhyrjen në fasadën jugore) të godinës ekzistuese A1 të Mjekësisë së Përgjithshme, brenda territorit të Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës”, me zhvillues Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**E D I R A M A**

**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

  
**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**

**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**